



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2020

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për **“Blerimi”** sh.p.k me adresë: fshati Mjekës, Njësia Administrative Shirgjan, rruga Elbasan-Cerrik km 4, Elbasan.

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 64683-07-08-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtimi i disa terreneve sportive në shkollën e mesme të përgjithshme “Dhaskal Todri” (faza e parë)”, me fond limit: 7,710,211 (shtatë milion e shtatëqind e dhjetë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, buxheti i Këshillit të Qarkut Elbasan dhe me financim nga OJF “Woman Center for Development Culture Albania”, dhe me afat për kryerjen e punimeve 1 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Blerimi” sh.p.k me Nipt: J 62903384 G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **7,700,000** (shtatë milion e shtatëqind mijë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **9,240,000** (nëntë milion e dyqind e dyzet mijë) **lekë** (me tvsh).

2. “Eurondërtimi 2000” sh.p.k me Nipt: K 02003001 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **5,691,736** (pesëmilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **6,830,084** (gjashtëmilion e tetëqind e tridhjetë mijë e tetëdhjetë e katër) **lekë** (me tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” sh.p.k. me Nipt: K 02003001 O

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Te kriteri i veçantë 2.1 Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë kërkohet:

a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, për vitin 2019.

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur në SPE Vërtetimin Nr.E-2396/1 nga Bashkia Tiranë dhe Vërtetimin Nr.137 nga Bashkia Vorë për taksat vendore të vitit 2019. Ndërkohë rezulton se në vitin 2019 operatori ekonomik ka zhvilluar aktivitet në Bashkinë Pogradec bazuar në ekstraktin historik të shoqërise Numri i çështjes CN-096851-02-19, është shtuar adresa dytësore "Korçë; Pogradec; Kantier ndërtimi në Rrugën Ismail Dërdusha-Rruga Industriale në bazë të kontratës nr. 18258/9" gjë që dokumentohet dhe në deklaratën mbi kontratat e lidhura apo në proces.Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Pogradec për të vërtetuar pagesën e detyrimeve vendore.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

2. Te kriteri i veçantë 2.3.8 Kapaciteti Teknik kërkohet:

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që kanë dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

| Nr | Lloji i Makinerive | Pronësia | Sasia |
|----|---|------------------------|--------|
| 1 | Eskavator me goma | Në pronësi ose me qira | Copë1 |
| 2 | Fadromë me goma | Në pronësi ose me qira | Copë1 |
| 3 | Kamioncinë vetëshkarkuese, me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton | Në pronësi ose me qira | Copë 4 |
| 4 | Mini damper | Në pronësi ose me qira | Copë 2 |
| 5 | Mjet ngritës me kosh | Në pronësi ose me qira | Copë 2 |

a) Për mjetet e mësipërme, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton

regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), çertifikatë pronësie, çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracion i vlefshëm i mjetit, fotot e tyre ku të duken qartë mjetet e mësipërme dhe çertifikatat e transportit.

Për plotësimin e kriterit 2.3.8 për mjetin Eskavator me goma, operatori ekonomik ka paraqitur Kontratë shitblerje, Akt-Zhdoganimi, faturë dhe foto ndërkohë që nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik, siguracionin e vlefshëm të mjetit.

Për plotësimin e kriterit 2.3.8 për mjetin Kamioncinë vetëshkarkuese, me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton, operatori ekonomik ka paraqitur mjetet me targat AA296LG, AA031YI, AA562NS por në dokumentat që i referohen këtyre mjeteve mungojnë çertifikatat e transportit lëshuar nga njësitë e pushtetit vendor për secilin prej tyre. Operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu mjetin me targe TR1598S i cili rezulton me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton dhe nuk plotëson kërkesat e dokumentave të tenderit.

Për plotësimin e kriterit 2.3.8 për mjetin Mini dumper, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument.

Për plotësimin e kriterit 2.3.8 për Mjet ngritës me kosh, operatori ekonomik ka paraqitur mjetet me targë AA418UC (autovinç) dhe një autovinç kantieri. Nga verifikimi i mjeteve të mësipërme rezulton se kemi të bëjmë me mjete të tipit autovinç për ngritjen e ngarkesave fizikë ndërkohë që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar mjete me kosh për ngritjen e punonjësve për realizimin e punimeve në lartësi.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Blerimi”** sh.p.k me

adresë: fshati Mjekës, Njësia Administrative Shirgjan, rruga Elbasan-Cerrik km 4, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **7,700,000** (shtatëmilion e shtatëqind mijë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** (pese) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anulojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 05.08.2020

Ankesa nuk ka pasur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari
Irland Sina**